



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.49/2017

Prishtinë, më 1 mars 2017

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Lirije Kajtazi, Salihe Mustafa, Mexhide Mjaku-Topalli, Mytaher Haskuka, Teuta Haxhiu, Shukrije Bytyçi dhe Kujtim Paqaku.

Munguan: Nenad Rashiq dhe Etem Arifi.

Stafi mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinator i Komisionit, Sulltane Gashi, zyrtarë e fushës, Burim Tahiri, mbështetës i Komisionit (UNICEF).

Pjesëmarrës të tjerë: Florije Kryeziu, Ardian Klaiqi dhe Timur Ramiqi- UNICEF; Valdrin Dervishaj-KOMF; Sanije Berisha-OSBE; Ahmet Rushiti-KDI; Alketa Lasku-Terre Des Hommes; Genta Gagica-Save The Children dhe Valdete Osmani-RTK.

Mbledhjen e kryesoi, Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit.

Anëtarët e Komisionit nuk patën vërejtje dhe as propozime të tjera për rendin e ditës, të propozuar nga kryetarja e Komisionit, andaj në vazhdim, Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e fëmijës;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mëparshme

Kryetarja, konstatoi se procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 30 janar 2017 dhe 8 shkurt 2017, u miratuan pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e fëmijës

Kryetarja, fillimisht falënderoi të gjitha organizatat mbështetëse të Komisionit që kontribuan në shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjit për mbrojtjen e fëmijës, në mënyrë që të bëhet një ligj sa më i mirë. Ajo tha se grupi punues ka mbajtur edhe një takim dhe tanimë i kemi punët më të konkretizuara për përmbylljen dhe miratimin e propozim-amendamenteve.

Më pas, fjalën ia dha deputetes Mexhide Mjaku Topalli, kryesuese e grupit punues për shqyrtimin e projektligjit.

Mexhide Mjaku-Topalli, tha se grupi punues ka mbajtur 6 takime pune për shqyrtimin e këtij projektligji, pjesë e grupit punues kanë qenë edhe deputetët: Teuta Haxhiu dhe Etem Arifi, por në shumë takime kanë marrë pjesë edhe anëtarë të tjerë të Komisionit. Ajo tha se pas këtyre punëve që janë bërë, edhe me mbështetjen e organizatave që na përkrahën në forma të ndryshme, ky projektligj prej karakterit që kishte, kryesisht deklarativ, me këto propozim-amendamente, besojmë se do të bëhet një ligj më i mirë dhe si i tillë do të gjejë zbatim në të ardhmen. Në mbledhjen e fundit të grupit punues, ku morën pjesë shumica e anëtarëve të Komisionit, kemi arritur që t'i shqyrtojmë të gjitha propozim-amendamentet.

Ajo theksoi se në mbledhjen e sotme, pret që të miratohen propozim-amendamentet.

Teuta Haxhiu, tha se vërtet, qysh në takimin e parë, për këtë projektligj, ka pasur dilema që të mos miratohet dhe t'i kthehet Qeverisë, për ripunim. Por, falë qëndrimit dhe vullnetit tonë për një punë sistematike dhe të përbashkët, kemi arritur që përmes propozim-amendamenteve, të bëhet një ligj mjaft i mirë.

Më pas, ajo theksoi se një motiv shtesë për këtë projektligj, ka qenë edhe vizita studimore në Suedi, ku disa nga amendamentet e propozuara janë bërë duke u bazuar në përvojën suedeze, siç është ai që njëri nga zëvendësit e Avokatit të Popullit, të jetë i dedikuar për mbrojtjen e fëmijëve, ku si propozim-amendament nuk është në kundërshtim me Ligjin për Avokatin e Popullit.

Salih Mustafa, theksoi se natyra e këtij projektligji ka qenë e tillë, që ka interferuar edhe në ligje të tjera dhe ka qenë problem harmonizimi në këtë projektligj. Në takimin e fundit të grupit punues ishte i pranishëm edhe zëvendësi i Avokatit të Popullit, z. Isa Hasani, për të marrë mendimin nëse ka kolizion me Ligjin për Avokatin e Popullit, që njëri nga zëvendësit e Avokatit të Popullit, të jetë adresë për mbrojtjen e fëmijës. Mendoj se

është bërë një punë e mirë dhe shpresoj se këto propozim-amendamente do të miratohen edhe në seancë plenare.

Mytaher Haskuka, tha se me disa pika nuk është i kënaqur në këtë projektligj por beson se me këto 39 propozim-amendamente që janë bërë, ky Projektligj është rregulluar mjaft mirë dhe se do të jetë më i zbatueshëm në praktikë.

Shukrije Bytyçi, tha se është një projektligj i rëndësishëm dhe besoj se pas miratimit në Kuvend dhe hyrjes në fuqi, të gjejë zbatim dhe do të mundësojë krijimin e kushteve më të mira për fëmijët në vendin tonë.

Kryetarja, pas këtyre diskutimeve, hodhi në votim të gjitha propozim-amendamentet, 39 sosh.

Kryetarja, konstatoi se Komisioni unanimitisht miratoi 39 amendamente në Projektligjin për mbrojtjen e fëmijës dhe vendosi që Raportin me amendamente ta procedojë për shqyrtim në komisionet e përhershme të Kuvendit.

3. Të ndryshme

Mexhide Mjaku-Topalli, propozoi që me rastin e 8 Marsit – Ditës Ndërkombëtare të Gruas, të ftojme në një takim përfaqësuesit e Agjencisë për Barazi Gjinore. Pastaj të ftojme koordinatoren nacional për mbrojtje nga dhuna në familje, të shohim çka është bërë me strategjinë dhe a është përfunduar ajo strategji.

Ajo, po ashtu, tha se kam kërkuar që të ftohet në Komision, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, është mirë që ky propozim të hyjë në agjendë të punës, sepse kemi shumë çështje për të diskutuar, sidomos lidhur me shtëpitë e fëmijëve, që është shqetësim shumë i madh.

Do të ishte mirë të takohemi me përfaqësueset e grave police dhe ato nga FSK-ja.

Ajo pyeti se a ka përgjigjeje nga Avokati i Popullit, i cili ka qenë i interesuar t'i drejtohet Gjykatës Supreme, lidhur me çështjen e punëtorëve të ish- ndërmarrjes “Sharr Salonit”.

Teuta Haxhiu, është mirë të koordinohemi dhe të bëjmë një vizitë sa më parë në burgun e Dubravës, që të shohim për së afërmi kushtet dhe cilat janë kërkesat e tyre, të shohim se a ka shkelje të të drejtave të njeriut në këtë institucion, gjithsesi edhe një vizite në shtëpitë e personave me të meta mendore në Deçan, por edhe 6 shtëpi të tilla në Kosovë.

Shukrije Bytyçi, tha se pajtohet që të ftohet në takim ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe janë dy çështje që do t'i kishte ngritur për diskutim, çështjen e familjeve me asistencë sociale, që janë diku 25 mijë familje me asistencë sociale dhe në momentin kur fëmijët i bëjnë 5 vite, kjo asistencë ndërpritet, dhe rreth çështjeve të pensioneve, duke e ditur që kemi gra të dëshmorëve që kanë qenë të punësuar, në momentin që dalin në pension, detyrohen që vetëm njërin pension ta gëzojnë.

Kryetarja, konstatoi në emër të Komisionit, se takimi i radhës do të mbahet të hënën, më 6 mars 2017, në orën 14:00, në të cilin do të ftohen përfaqësuesit e Agjencisë për Barazi Gjinore, në mënyrë që të kemi një informatë apo raport mbi gjendjen e barazisë gjinore në Kosovë.

Mbledhja e Komisionit përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Lirije KAJTAZI